

Ish-ministria e
Jashtme: Lista Serbe të
mos certifikohet për
zgjedhje lokale



FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com

Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

**YMERI: ASOCIACIONI, MË I
DËMSHËM SE AI I VITIT 2015**

FAQE 4-5



Ish-kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri, ka thënë se sjellja kokëfortë e kryeministrit Albin Kurti po ia vështirëson Kosovës pozitën në dialogun me Serbinë, ndërsa

zgjedhjet e parakohshme i sheh të pashmangshme. Ai ka thënë se propozimi aktual i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është më i dëmshëm se ai i vitit 2015.

“Nuk është se siguroam ndonjë Kosovë më sovranë, përkundrazi mendoj që tash do të jetë një situatë shumë më ndryshe edhe në pjesën veriore”, ka thënë Ymeri

**VIZITA E KURTIT NË SHSKUK,
DEPUTETI HAXHIU TREGON SI U
TURPËRUA KURTI: DËSHTIM PËR
TRI VJET NË SHËNDETËSI**

F. 3



**QEVERIA PREMTON SE SHUMË
SHPEJT DO TË NISIN PUNIMET
PËR RESTAURIMIN E REZIDENCËS
SË RUGOVËS**

F. 6

AKTUALE



**BIDENI PËRMEND BALLKANIN KUR
FLET PËR RËNDËSINË E NDIHMËS
PËR UKRAINËN**

F. 2

**IU DHA LAMTUMIRA 18-VJEÇARIT
NGA PODUJEVA QË U RRAH PËR
VDEKJE**

F. 6

**UNIVERSITETI I KARLIT RIHAP DYERT
NJË MUAJ PAS TË SHTËNAVE MASIVE**

F. 2

EKONOMI



**SHMANGIA NGA TATIMET
I KUSHTON BUXHETIT
MBI 700 MILIONË EURO**

F. 7

**PRITEJ TË PËRFUNDONTE MË 2023,
AUTOSTRADA PRISHTINË - GJILAN,
KANTIER NDËRTIMI ME GROPA DHE
BALTË**

F. 7

SPORT



**FITORJA E 11-të RADHAZI PËR
TREPÇËN, PRISHTINA MPOSHTI
ISTOGËN**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni përmend Ballkanin kur flet për rëndësinë e ndihmës për Ukrainën

WASHINGTON, 21 JANAR - Presidenti amerikan Joe Biden e ka përmendur Ballkanin dhe rrezikun që i kanoset në rast se Shtetet e Bashkuara nuk vazhdojnë të dërgojnë ndihmë për Ukrainën, e cila po përballet me pushtimin rus prej shkurtit të vitit 2022.

Duke folur pas një konference me kryetarë të shteteve amerikane, më 19 janar Bideni e ka përmendur pozitën e fuqishme të Shteteve të Bashkuara në botë dhe sfidat me të cilat po përballet vendet e tjera. “Nëse ne ndalemi dhe Rusia vazhdon të luftojë dhe mposhtet Ukraina, çfarë mendoni se do të ndodhë me vendet e Ballkanit? Çfarë do të ndodhë me Poloninë deri te Hungaria? Seriozisht, mendoni për këtë. E ndryshon dinamikën”, ka thënë Bideni, sipas Shtëpisë së Bardhë. Shtetet e Bashkuara, të cilat

kanë ndihmuar më së shumti Ukrainën, prej nisjes së luftës, aktualisht përballet me bllokadë të disa republikanëve konservatorë, të cilët kanë dalë kundër ndarjes së mëtejshme të ndihmës për këtë shtet. Në pakon e Bidenit për ndihmë parashihen 50 miliardë dollarë për Ukrainën dhe 14 miliardë për Izraelin.

Edhe Bashkimi Evropian nuk ka arritur të ndajë fonde në vlerë të 50 miliardë dollarëve për Ukrainën për shkak të vetos që e ka përdorur Hungaria.

Muajin e kaluar shefja e Zyrës së ShBA-së për Buxhet, Shalanda Young, ka thënë në një letër dërguar udhëheqësit të Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson, që nëse ndihma ushtarake përfundon, atëherë Kievi do të gjunjëzohet ndaj pushtimit rus.

Në total Shtetet e Bashkuara



kanë ndarë 111 miliardë dollarë për Ukrainën, prej nisjes së luftës, përfshirë 67 miliardë dollarë për blerje të pajisjeve ushtarake.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj

Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Edhe sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, pati përsëritur në nëntor të vitit të

kaluar, se gjëja e fundit që do Perëndimi në rajonin e Ballkanit Perëndimor është rikthimi i konflikteve, teksa e pati përmendur rëndësinë e pranisë së NATO-s.

Pas sulmeve në Banjskë të Zveçanit, në shtator të vitit të kaluar, KFOR-i, misioni i NATO-s në Kosovë, e ka rritur praninë në këtë vend dhe tani ka 4 500 pjesëtarë.

Më 24 shtator një grup i armatosur serb e ka sulmuar Policinë e Kosovës, duke e vrarë rreshterin Afrim Bunjaku.

Kosova e ka fajësuar shtetin e Serbisë për sulmin, ndonëse kjo e fundit ka mohuar gjithçka. Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë.

Agjencia Ndërkombëtare e Policisë (INTERPOL) tashmë ka lëshuar fletarrestim për të.

Rusia tejkalon Arabinë Saudite për furnizim të Kinës me naftë



MOSKË, 21 JANAR - Rusia e ka tejkaluar Arabinë Saudite vitin e kaluar, duke u bërë furnizuesja më e madhe me naftë e Kinës, ka raportuar agjencia e lajmeve “Reuters”, duke cituar të dhënat kineze për import.

Rusia besohet se ka dërguar sasi të barasvlershëm me 2.1 milionë fuçi naftë në ditë.

Arabia Saudite, furnizuesja kryesore e Kinës për naftë, ka dërguar 86 milionë tonë, 2 për qind rënie në krahasim me vitin paraprak.

Kina është importuesja më e madhe e naftës në botë, duke i tejkaluar edhe Shtetet e

Bashkuara më 2017.

Sanksionet e Perëndimit të vendosura ndaj Rusisë, për luftën e nisur në Ukrainë, në shkurt të vitit 2022 kanë çrregulluar për një kohë tregtinë globale, përfshirë dërgesat e lëndëve djegëse të papërpunuara.

Evropa, blerësjë më e madhe e naftës ruse, para luftës u ka vënë ndalesë lëndëve djegëse ruse të papërpunuara dhe, bashkë me Shtetet e Bashkuara, kanë vendosur çmime tavan në naftën ruse që është bartur duke shfrytëzuar shërbimet evropiane apo amerikane, siç është sigurimi gjatë udhëtimit.

Çmimi tavan është menduar për ta mbajtur naftën ruse jashtë tregjeve globale dhe për të parandaluar një rritje çmimesh.

Eksportet e naftës përbëjnë më shumë se 30 për qind të të hyrave federale në Rusi.

Pas ndalesës së vënë të Perëndimit në naftë, India dhe Kina kanë shprehur gatishmëri për ta blerë naftën që Rusia, më pas, e ka shitur me çmim më të lirë.

Rusia dhe Arabia Saudite janë në vendin e dytë dhe tretë, respektivisht për prodhim të naftës në botë pas Shteteve të Bashkuara.

Universiteti i Karlit rihap dyert një muaj pas të shtënave masive

PRAGË, 21 JANAR - Saktësisht një muaj pas të shtënave vdekjeprurëse në Universitetin e Karlit në Pragë, ky institucion është rihapur pjesërisht të dielën për studentët, profesorët dhe personat e tjerë të interesuar.

Gazetarëve dhe fotografëve u është kërkuar të mos marrin pjesë në hapje.

Dega e Arteve në këtë universitet çek është tronditur më 21 dhjetor 2021, kur një student ka nisur të shtëna masive me armë zjarri, duke vrarë 14 persona dhe duke

plagosur shumë të tjerë. Ai më pas ka vrarë veten.

Aktualisht janë duke u zhvilluar shumë hetime për sulmuesin dhe përgjigjen e policisë çeke ndaj sulmit.

Qëllimi i rihapjes së Fakultetit të Arteve të dielën është t’u ndihmojë studentëve dhe stafit t’i kthehen jetës akademike, me ligjërata të shkurtra, shkëmbime librash dhe performanca muzikore.

Zyrtarët kanë bërë me dije se do të ofrohen edhe konsulta psikologjike për ata që kanë nevojë.

Besohet se riparimet në katin e katërt të ndërtesës, ku ka ndodhur sulmi, do të kushtojnë dhjetëra mijëra euro.

Ligjëratat e rregullta për semestrin pranveror në këtë fakultet do të nisin më 19 shkurt, përveç katit të katërt.

I themeluar më 1347, Universiteti i Karlit është më i vjetri dhe më i madhi në Republikën Çeke dhe një prej institucioneve edukative më të vjetra në Evropë.

Sulmi i 21 dhjetorit ka qenë më i rëndi në historinë moderne të Çekisë.



Musliu: Vuçiqi ka frikë nga çdo lëvizje e avokatit Çedomir Stojković

PRISHTINË, 21 JANAR - Agim Musliu, drejtori i Institutit Octopus, ka folur për taktikat e fundit të qeverisë serbe pas situatës me avokatin Çedomir Stojković, i cili u përball me ndalim dhe pyetje në aeroportin “Nikola Tesla” pasi kishte bërë homazhe në Prekaz.

Stojković, avokati i Nikola Sandulovićit, i cili ishte sulmuar brutalisht nga BIA, Agjencia e Inteligjencës së Serbisë, ishte vizitues i Komplexit Memorial “Adem Jashari” dhe vendosi një kurorë lulesh në varrin e Blerina Jasharit, të vrarë nga forcat serbe gjatë luftës në

Kosovë. Gjatë qëndrimit ai shkroi një homazh në librin e kujtimeve për Blerina Jasharin. Musliu e përshkruan këtë akt si një shenjë të frikës nga autoritetet në Beograd për çdo person që synon paqen në Ballkan si në rastin e

Stojkovićit, i cili është zë për drejtësi në rajon. “Qeveria e Serbisë (Vuçiq) tani ka frikë nga çdo lëvizje e njeriut që ka mundësi të bëjë paqe në Ballkan, avokatit dhe luftëtarit për drejtësi, Çedomir Stojković!”, ka shkruar Musliu në platformën “X”.



Tre turistë nga Kosova bllokohen nga bora në Valbonë, shpëtohen nga policia shqiptare dhe Emergjencat Civile të Kosovës



PRISHTINË, 21 JANAR - Tre turistë nga Kosova janë shpëtuar pasi kishin mbetur në një terren të mbrehtë në Valbonë të Shqipërisë. Policia e Shqipërisë njoftoi se ata u shpëtuan pas një angazhimi të tyre në bashkëpunim me Emergjencat Civile të Kosovës. “Rreth orës 11:00 Emergjencat Civile të Kosovës kanë njoftuar se tre turistë nga Kosova, duke eksploruar alpet e Valbonës, me motorë bore, kishin mbetur të bllokuar për shkak të terrenit të thepisur dhe me dëborë. Menjëherë pas marrjes së njoftimit, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Tropojë, në bashkëpunim me

Emergjencat Civile të Kosovës, kanë organizuar punën dhe kanë nisur kërkimet, me qëllim lokalizimin e turistëve. Pas disa orësh kërkime nga shërbimet e Policisë, në bashkëpunim me Emergjencat Civile të Kosovës, në vendin e quajtur ‘Ura Pojanes’, u lokalizua turisti që kishte mbetur i bllokuar, ndërsa dy turistët e tjerë kishin arritur të dilnin në zonën e Kosovës. Turisti ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore. Ai ka falënderuar shërbimet e Policisë dhe Emergjencat Civile të Kosovës për ofrimin e menjëhershëm të ndihmës”, ka njoftuar Policia e Shqipërisë.

Vizita e Kurtit në ShSKUK, deputeti Haxhiu tregon si u turpërua Kurti: Dështim për tri vjet në shëndetësi

PRISHTINË, 21 JANAR - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Bekim Haxhiu, ka reaguar për vizitën e kryeministrit Albin Kurti në ShSKUK. Ai në “Facebook” ka shkruar se Kurti, i turpëruar për gjendjen në Kujdesin Intensiv dhe në ShSKUK, u detyrua që intervistën për medie ta japë para Klinikës së Stomatologjisë. “Ta ‘promovojë’ implantin-mbjelljen e dhëmbit, e që është pasojë e dështimit në parandalim dhe shërim të dhëmbit. Kryeministër, pse nuk fole për gjendjen në shëndetësi para kujdesit intensiv, aty ku po trajtohet Elza Ujkani?! Pse nuk fole për gjendjen buzë kolapsit në Klinikën e Kujdesit Intensiv? A të treguan sa është e lartë përqindja (%) e vdekshmërisë në kujdesin intensiv? Pse menaxherët e emëruar nga qeveria Kurti e kanë



zvogëluar numrin e shtretërve në kujdesin intensiv dhe kanë zvogëluar

resurset njerëzore? Pse nuk fole për gjendjen në emergjencë, aty ku luftohet të

shpëtohet jeta, e që ju për tri vjet nuk keni bërë asnjë investim në aparatura dhe

pajisje mjekësore apo trajnim të stafit?”, ka shkruar deputeti Haxhiu. Ai ka theksuar se për këto tri vjet, dështimi është strategjia e vetme e qeverisë Kurti në shëndetësi. “Deri më tani asnjë hap të vetëm për implementim të sigurimeve shëndetësore. Listat e pritjes për operacione dhe procedura diagnostikuese janë rritur me vite, mungesat e barnave dhe materialit shpenzuese janë të përditshme, mburrja me mbjelljen e dhëmbëve tregon se kjo qeveri as nuk e kupton se cilat janë prioritetet në shëndetësi”, ka thënë Haxhiu. Ai në fund ka theksuar se në çfarë cilësie Kurti e vizitoi ShKSUK-në. “P. s.: Në çfarë cilësie e vizitoi Albin Kurti ShSKUK-n: si kryetar i Komisionit për Shëndetësi, si i vetëmëruar apo si i pari i qeverisë së dështuar”, ka deklaruar Haxhiu.

Në 24 orët e fundit në Kosovë kanë ndodhur 63 aksidente trafiku

PRISHTINË, 21 JANAR - Në 24 orët e fundit në vendin tonë kanë ndodhur 63 aksidente trafiku. Sipas raportit të policisë, 17

prej aksidenteve kanë qenë me persona të lënduar, kurse 46 të tjerë vetëm me dëme materiale. Brenda 24 orëve

janë shqiptuar edhe 966 tiketa trafiku për personat që nuk kanë respektuar rregullat e komunikacionit, ndërsa janë

arrestuar 11 persona, 8 prej tyre janë dërguar në mbajtje, kurse një në vuajtje të dënimit.





Ymeri: Asociacioni, më i dëmshëm se ai i vitit 2015

Ish-kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri, ka thënë se sjellja kokëfortë e kryeministrit Albin Kurti po ia vështirëson Kosovës pozitën në dialogun me Serbinë, ndërsa zgjedhjet e parakohshme i sheh të pashmangshme. Ai ka thënë se propozimi aktual i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është më i dëmshëm se ai i vitit 2015. “Nuk është se siguroam ndonjë Kosovë më sovranë, përkundrazi mendoj unë që tashti do të jetë një situatë shumë më ndryshe edhe në pjesën veriore”, ka thënë Ymeri.

PRISHTINË, 21 JANAR - Ish-kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri, ka thënë se sjellja kokëfortë e kryeministrit Albin Kurti po ia vështirëson Kosovës pozitën në dialogun me Serbinë, ndërsa zgjedhjet e parakohshme i sheh të pashmangshme. Për këtë të fundit, sipas Ymerit, në sytë e ndërkombëtarëve mund të shihen edhe si tendencë për t'i ikur dialogut dhe përgjegjësisë që i ka marrë nga tryeza e bisedimeve. Në një intervistë për “Ekonomia

Online”, ish-kreu i LV-së ka thënë se mungesa e bashkërendimit me bashkësinë ndërkombëtare ka lënë pasoja të rënda. Ndonëse krerët e shtetit deklarojnë se Kosova ka shtrirë sovranitet në veri, Ymeri e sheh të kundërtën, duke thënë se “nuk e siguroam ndonjë Kosovë më sovranë”. Ymeri ka deklaruar se sjellja e kryeministrit nuk ka prodhuar rezultate të mira. Madje përmend edhe implementimin e Asociacionit, të cilin e quan më të dëmshëm se të vitit 2015.

“Unë mendoj se sjellja e qeverisë, sjellja e kryeministrit tonë, po ia vështirëson pozitën Kosovës në dialog. Mendoj se sot jemi në një situatë në të cilën mungesa e bashkërendimit me bashkësinë ndërkombëtare, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i ka shkaktuar dëme Kosovës dhe në fund nuk kemi arritur ndonjë gjë me sjelljen tonë kokëfortë. Nuk e shmangëm zbatimin e Asociacionit, përkundrazi u dashtë ta pranojmë një edhe më të dëmshëm se i vitit 2015, pra nuk është se siguroam ndonjë Kosovë më sovranë, përkundrazi mendoj unë që tashti do të jetë një situatë shumë më ndryshe edhe në pjesën veriore edhe pse po duket formalisht që atje kanë ndryshuar situatat në kuptimin e pranisë së institucioneve e kështu me radhë”, ka thënë Ymeri. Në këtë intervistë Ymeri ka përmendur edhe sulmin terrorist në Banjskë. Ai vlerëson lart bashkërendimin që e kanë pasur institucionet e Kosovës

me bashkësinë ndërkombëtare. Të njëjtën e kërkon edhe në rastet e tjera. “Për shembull, të gjithë ndërkombëtarët për rastin e Banjskës e kanë vlerësuar bashkërendimin e institucioneve tona të sigurisë me partnerët tanë ndërkombëtarë, që i bie se kjo është lëvdatë. Nëse e merr dhe e krahason Banjskën, që ka qenë aksion ose veprim policor shumë më i vështirë se ballafaqimi me trazirat dhe protestat e majit, policia ka dalë shumë më e suksesshme në Banjskë sesa që ka dalë në maj dhe kjo është për shkak të bashkërendimit me bashkësinë ndërkombëtare”, ka thënë Ymeri. Ndonëse është kërkesë e vazhdueshme e faktorit ndërkombëtar që marrëveshja të nënshkruhet sa më shpejt, Ymeri ka një qëndrim ndryshe. Ai përmend deklaratimet e BE-së dhe ShBA-së se marrëveshja është obliguese, pavarësisht se e njëjta nuk është e nënshkruar. E vonesat e nënshkrimit, Ymeri i sheh si taktizim të Kurtit për ta

vonuar. “Shtetet të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë thënë se kjo marrëveshje është obliguese për palët dhe është në fuqi pavarësisht që nuk është nënshkruar. Në këtë drejtim konsideroj se Kosova ose kryeministri Kurti po më duket që po e përdorin këtë nënshkrimin si lloj taktizimi për të nxjerrë diçka tjetër, por jo që do të ketë ndonjë efekt kushedi se çfarë edhe po të kishte qenë e nënshkruar marrëveshja. Mendoj se zbatimin e garanton vetëm trysnia ndërkombëtare e për trysninë ndërkombëtare mjaftohet që të dy liderët kanë thënë po në Bruksel fillimisht, pastaj në Ohër për aneksin. Kjo marrëveshje është pjesë integrale e rrugëtimit tonë drejt Bashkimit Evropian”, ka deklaruar Ymeri. E paralajmërimet e fundit për zgjedhje të parakohshme, Ymeri i sheh të pashmangshme, por që ngre dyshime për arsyen e vërtetë të zgjedhjeve të reja.

Ish-ministrja e Jashtme: Lista Serbe të mos certifikohet për zgjedhje lokale

Prishtinë, 21 janar - Ish-ministrja e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, ka vazhduar të jetë e zëshme ndaj ndarjes së 360 mijë eurove për Listën Serbe nga ana e KQZ-së. Ajo ka thënë se tani kur i gjithë kapaciteti diplomatik e politik i Kosovës është fokusuar për të pasur një reagim të qartë ndërkombëtar për rolin e Serbisë përmes lidershit të Listës Serbe në agresionin e Banjskës, vendimi për dhënien e mjeteve kësaj organizate kriminale prej 360 000 eurosh nga KQZ-ja është nëpërkëmbje e shtetit të Kosovës, mungesë ligjshmërie e integriteti nga institucionet e përgjegjëse si dhe “amnisti” institucionale për agresionin e Banjskës dhe vrasjen e heroit Afrim Bunjaku. “Nëse institucionet e vendit - specifikisht presidentja e kryeministri - vazhdojnë të heshtin për këtë situatë të rrezikshme, atëherë do të duhej të mbajnë përgjegjësi për rietablimin e serishëm në pushtet të organizatës kriminale

Lista Serbe në komunat veriore. Pres ndërhyrjen e presidentes së vendit rreth vendimit skandaloz të KQZ-së, që përmes kryesuesit ta ruajë integritetin e shtetit dhe ta rikthejë ligjshmërinë në vendimet e KQZ-së. Po ashtu, nëse vendimi është marrë përmes votimit të përfaqësuesve të partive politike në KQZ - atëherë duhet t’i mbajnë përgjegjëse edhe partitë politike të cilat kanë votuar pro vendimit për ndarjen e mjeteve për Listën Serbe për të mos rrezikuar fondet për partitë e tyre”, ka shkruar Haradinaj-Stublla. Ajo ka theksuar se vendimi i KQZ-së duhet të rishikohet dhe forca e ligjit të Republikës së Kosovës duhet ta ndalojë organizatën kriminale Lista Serbe nga aktiviteti në territorin e Kosovës, po ashtu ta parandalojë certifikimin dhe pjesëmarrjen e saj në zgjedhjet e ardhshme në komunat veriore nëse nuk duam t’ua servojme me duart tona “parathënien për aneksimin” e veriut të Kosovës.



Tiranë, nderohen viktimat e 21 janarit, mes shpresave për rihetim të çështjes

TIRANË, 21 JANAR - Në Tiranë, përfaqësues të shumicës socialiste dhe familjarë të viktimave në demonstratën e 21 janarit 2011, përkujtuan të dielën 13-vjetorin e asaj ngjarjeje, kur u vranë me armë zjarri nga Garda 4 protestues dhe u plagosën shumë të tjerë. Ata bënë thirrje për ndriçimin e plotë të kësaj ngjarjeje dhe për nxjerrjen para drejtësisë të zyrtarëve që urdhëruan hapjen e zjarrit ndaj protestuesve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nxori nëntorin e kaluar një vendim, ku theksohet që, në hetimet për çështjen e 21 janarit, janë vërejtur mangësi të shumta, të cilat ngrehin dyshime se autoritetet u përpoqën ta devijonin apo të ndërhyjnë padrejtësisht në to. Në ceremoninë përkujtimore të demonstratës së 21 janarit, Mark Nika, xhaxhai i Aleks Nikës, njërit prej 4 të vrarëve gjatë protestës, tha se këto janë 13 vjet të manipulimit dhe pengimit të drejtësisë, fshehjes së krimit shtetëror, ndërsa Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut riktheu shpresat për drejtësi, duke konfirmuar shmangien e hetimit me veprime të përcipta dhe gjykim farsë, duke lënë jashtë përgjegjësit e vërtetë për vrasjen qytetarëve të pafajshëm. “Ata ishin protestues paqësorë dhe të katërt u vranë larg hyrjes së kryeministrisë, kur protesta po shpërndahej, kur nuk kishte asnjë arsye që të përdorej dhuna, e jo më armët e zjarrit,



e jo më të qëllohej në mish. Të katërt u vranë në bulevard. Asgjë tjetër, veç një urdhër nga lart mund të çonte në hapjen e zjarrit drejt qytetarëve në ato kushte”, tha Nika. Duke përmendur prokurorinë e Tiranës si autore e zvarritjes së kësaj çështjeje, kryeministri Edi Rama tha se, nga ana tjetër, sistemi i drejtësisë po zgjohet pas reformimit, se institucionet e reja të saj po japin shenja dhe shpresë që drejtësia mund të bëhet dhe tashmë vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut erdhi si një dritë në

fund të tunelit, teksa e cilëson 21 janarin si një krim shtetëror të pahetuar. “Nga Gjykata e Lartë më 27 shkurt, pak më shumë se një muaj prej sot, do të mësojmë nëse dosja e gjakut të 21 janarit do t’i kalojë për shqyrtim SPAK-ut për ta hapur për së mbari hetimin e krimit shtetëror në bazë të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, apo do të vazhdojë të mbetet e mbyllur për Zoti e di sa kohë në barkun e madh të prokurorisë pa shtyllë kurrizore të rrethit gjyqësor të Tiranës”, tha Rama. Ndërsa ministri i Drejtësisë,

Ulsi Manja, tha se shumica socialiste e reformoi sistemin gjyqësor me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë, megjithatë çështja e 21 janarit është ende në ajër. “Por ajo nuk mund të mbahet peng nga disa magjistratë frikacakë, eunukë e të paafte brenda sistemit, që tundin në dorë një certifikatë vetingu dhe përpiqen të mbyllin me procedura të vërtetën e asaj ngjarjeje, si dhe shumë të tjera që mbajnë në tryezat e tyre të punës”, tha ministri Manja. Nëntorin e kaluar Gjykata Evropiane e të Drejtave të

Njeriut publikoi një vendim ku theksoi se autoritetet duhet t’i vazhdojnë përpjekjet për zbardhjen e vdekjes së Nikës si dhe t’i identifikojnë e ndëshkojnë përgjegjësit e 21 janarit mbi zinxhirin komandues të të cilëve hetimet nuk kishin zbardhur natyrën e urdhrave të mundshëm, por ishin përqendruar mbi individë oficerë të Gardës. Gjykata doli në përfundimin se hetimi i çështjes nuk ishte i frytshëm, sepse nuk përcaktoi të vërtetën apo të çonte në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës. Sipas vendimit, zyrtarë të kohës kishin ndërhyrë në mënyra të ndryshme për të mos u bërë saktë dhe shpejt ekspertime, dëshmi dhe arrestimet e të dyshuarve, ndërhyrje që ndikuan mbi hetimet. Ish-kryeministri Berisha është shprehur se nuk i ka penguar hetimet, se nuk kishte asnjë kundërshtim ndaj vlerësimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke akuzuar Edi Ramën si autor i asaj demonstrate të dhunshme. Demonstrata e organizuar më 21 janar 2011 nga Partia Socialiste me thirrjet “O Sali, dorëzo bllokun!”, kishte në qendër aferat korruptive, që dyshohej se numëronte në një bllok shënimesh ish-ministri Ilir Meta, i shfaqur në media nga një filmim i fshehtë, por ajo u mbyll pas shumë orë përplasje me policinë me 4 vrasje të protestuesve dhe shumë të plagosur.

Iu dha lamtumira 18-vjeçarit nga Podujeva që u rrah për vdekje

PODUJEVË, 21 JANAR - Në varrezat e “Qytetit të Hekurudhës” të dielën në Podujevë është varrosur Lulzim Fejzullahu, 18-vjeçari që vdiq gjatë pasdites të së shtunës në QKUK pas plagëve që kishte marrë nga goditja me veturë dhe rrahja brutale nga dy të mitur, rreth një javë më parë. Në varrimin e tij, përveç familjarëve e të afërmeve, morën pjesë shumë qytetarë.

E Rrahim Fejzullahu, xhaxhait i 18-vjeçarit, gjatë mëngjesit të së dielës ka treguar se nipi i

tij u godit dhe më pas u rrah për vdekje nga dy të mitur. Ai ka treguar se i gjithë rasti ka nisur te berberi dhe, sipas informacioneve të tij, ka qenë një fjalosje e rastit. “Lulzimi ka qenë një djalë i pasherr, pa problem. Lulzimi ka qenë punëtor. Ka punuar në një hamburger (fast-food). E ka mbajtur veten. Ka qenë jetim, pa baba e pa nënë. Lulzimi së pari ka kontaktuar me ata që e kanë sulmuar. Është një rrojtore që rruhen njerëzit. Aty janë rrokë. Sipas informatave që deri më sot i kam, kanë

qenë te berberi. Ka qenë duke i hequr flokët. Këto informata i kam. Jo s’mundesh ti para meje, jo mundesh, si shqiptarët qysh e kanë zakon. E kanë rrokë njëri-tjetrin me krahë. Kush kënd e ka rrokë nuk e di. Lokali është rreth 20 metra larg nga këtu. Të shtunën janë rrokë atje e të dielën ka përfunduar aty pa vetëdije”, ka thënë Fejzullau në një prononcim për medie. Ai ka treguar se pasi e kanë goditur me veturë, ata e kanë sulmuar me një mjet të fortë dhe shkelma e grushte.



Qeveria premton se shumë shpejt do t’i nisë punimet për restaurimin e Rezidencës së Rugovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 JANAR - Me rastin e 18-vjetorit të vdekjes së ish-presidentit Ibrahim Rugova, qeveria Kurti ka premtuar se shumë shpejt do të nisin punimet për restaurimin e Rezidencës së Rugovës. “Në nderim të figurës së tij dhe kontributit të madh për kombin dhe shtetin tonë, bashkë me zëvendëskryeministren Gërvalla dhe ministrin Çeku vizituam familjen Rugova: bashkëshorten Fanë, vajzën

Teuta, djemtë Mendimin dhe Ukën me bashkëshortet e tyre Blerinën dhe Blertën. Na pritën në Rezidencën e Presidentit Rugova, aty ku ai kishte pritur personalitete të mëdha botërore dhe ku janë marr vendime të rëndësishme e përcaktuese për fatin e shqiptarëve dhe të Kosovës. Në këtë shtëpi dr. Rugova zhvilloi aktivitetin e tij nga viti 1993 e deri në ditën e fundit të jetës. Për shkak të vlerave që posedon, kjo ndërtesë është shpallur aset i mbrojtur i trashëgimisë kulturore më

2016. Familjen Rugova e njoftuam se së shpejti do të nisin punimet për restaurimin e Rezidencës së Presidentit Ibrahim Rugova”, ka thënë kryeministri Albin Kurti. Ai ka theksuar se ky projekt dhe investim i qeverisë është dëshmi e përkushtimit të tyre për t’i nderuar personalitetet e larta dhe ngjarjet historike të rrugëtimit shtetformues, nga ilegalja, lëvizjet studentore, rezistenca paqësore, lufta çlirimtare e deri te shteti i pavarur e sovran që e gëzojmë sot.

Vazhdon programi i shkollës politike të Lëvizjes Vetëvendosje

PRISHTINË, 21 JANAR - Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se këtë javë në nivelin politiko-organizativ u mbajtën ligjëratat mbi historinë dhe teorinë e feminizmit.

Nazlie Bala në Prishtinë dhe Agnesë Kastrati në Ferizaj paraqitën disa nga tezat kryesore të feminizmit të majtë. Dallimet ideologjike, ato doktrinale si dhe personazhet kryesore që e kanë emërtuar këtë histori të madhe të përpjekjes dhe sakrificave të jashtëzakonshme.

Në ligjëratat u paraqitën çështja e gruas, historiku mbi lëvizjet feministe në botë, lëvizja në

Kosovë, valët e feminizmit dhe çështjet që lëvizjet feministe patën në qendër të angazhimit mbi situatat politiko-shoqërore që nxitën e formësuan aktivizmin feminist.

Po ashtu, ligjërueset paraqitën dhe angazhimin e grave shqiptare si pjesë cruciale e luftës së UÇK-së, veçanërisht e organizatave ilegale që vepruan në Kosovë dhe i paraprinë luftës.

Në nivelin teorik, profesor Gent Carrabregu vijoi ligjëratat në kursin e logjikës formale. U paraqitën, përveç koncepteve themelore, shembuj dhe ushtrime të silogjizmave



aristotelianë.

Ndërsa në kuadër të ligjëratave mbi shkencat politike, profesor Armend Mazreku ligjëroi mbi

teorinë e liberalizmit si një nga shkollat e mëdha të mendimit politik e shoqëror, si dhe mbi filozofët anglezë që e

themeluan dhe përfaqësojnë këtë shkollë si Thomas Hobbes e John Locke. I pari paraprirës i liberalizmit, i dyti themelues i liberalizimit.

U diskutua gjatë ligjëratës mbi ato që ende sot i kemi të trashëguara në sistemet tona të demokracisë liberale përfaqësuese, kontratën sociale, teorinë e qeverisjes liberale, si dhe konceptet themelore të të drejtave të individuale, atyre pronësore, konceptin e ndarjes së pushteteve. Shkolla politike e Lëvizjes vijon javën e ardhshme me ligjëratat në të dyja nivelet e saj.

18 vjet nga vdekja e Rugovës, Osmani, Kurti, Hovenieri dhe Szunyogi bëjnë homazhe te varri i tij



Prishtinë, 21 janar - Ambasadori amerikan Jeff Hovenier ka bërë homazhe të dielën te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova. Hovenier në “X” ka shkruar se trashëgimia e presidentit Rugova është frymëzim në Kosovë dhe në mbarë botën. “Sot iu bashkova presidentes

Vjosa Osmani, kryeministrit Albin Kurti dhe liderëve të tjerë të Kosovës për ta nderuar dr. Ibrahim Rugovën në 18-vjetorin e vdekjes së tij. Trashëgimia e presidentit Rugova - ajo e një lideri që avokoi për rezistencë paqësore duke kërkuar të drejta dhe liri të

barabarta për të gjithë qytetarët - është një frymëzim këtu në Kosovë dhe në mbarë botën”, ka shkruar ambasadori amerikan. Homazheve u është bashkuar edhe Tomas Szunyog, shef i Zyrës së BE-së në Kosovë.

Shmangia nga tatimet i kushton buxhetit mbi 700 milionë euro

PRISHTINË, 21 JANAR - Shmangia nga tatimet i kushton buxhetit të Kosovës qindra miliona euro në vit. Më shumë se 30 për qind e brutoprodhimit të brendshëm është ekonomi joformale, sipas disa të dhënave që kanë përpiluar zyrtarë të Bashkimit Evropian. Ato janë publikuar edhe në Raportin e Progresit për Kosovën në fund të vitit të kaluar. Përkthyer në shifra nga ish-ministri i Ekonomisë i Kosovës, Haki Shatri, kjo nënkupton mbi tre miliardë euro.

Me ligjin për ndarjet buxhetore këtë vit, brutoprodhimi i brendshëm parashihet të jetë rreth 10.6 miliardë euro. Duke vënë në dukje seriozitetin e problemit, Shatri thotë se shmangia nga tatimet vërehet kudo, nisur nga mospagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar, tatimit në pagë e deri te shitja e produkteve pa kupon fiskal.

Nëse shteti do të arrinte t'i mbledhte të gjitha - që e tejkalojnë vlerën 25 % - Shatri thotë se buxhetit të sivjetmë prej 3.3 miliardë eurosh do t'i shtoheshin edhe mbi 700 milionë.

Të ardhurat shtesë, sipas tij, “do të siguronin paga më të larta, investime në projekte kapitale, në sektorin e energjisë, por edhe në transfere sociale”. “Do të mund të ndërtoheshin apo digjitalizoheshin shkollat, të investohej në spitale... Pra, do të përmirësohej mirëqenia e qytetarëve të Kosovës”, shton ai për Radion Evropa e Lirë.

Përveç ndikimit në të hyrat buxhetore, shmangia nga tatimet krijon edhe konkurrencë të padrejtë në treg, thotë ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, tani udhëheqës i Institutit Hulumtues për Ekonomi dhe Financa. Sipas tij, bizneset që i shmangin tatimet përfitojnë padrejtësisht kundrejt atyre që e respektojnë ligjin. “Shumë biznese

vazhdojnë t’u ikin obligimeve tatimore që i kanë ndaj shtetit”, thotë ai.

Me ligjin në Kosovë të gjitha bizneset janë të obliguara të pajisen me arka fiskale dhe, rrjedhimisht, të lëshojnë kupon fiskal për çdo blerje të realizuar. Sipas Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, e cila funksionin në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në Kosovë janë të regjistruara mbi 236 mijë biznese, por nuk është e qartë se sa prej tyre janë aktive.

Të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës tregojnë se numri i bizneseve të fiskalizuar është mbi 44 mijë. E sipas të dhënave të Institutit Riinvest, që promovon zhvillimin modern ekonomik në Kosovë, janë 23 deri në 25 për qind e bizneseve që u shmangen obligimeve tatimore, duke i nënraportuar shitjet.

Drejtori ekzekutiv i këtij instituti, Alban Hashani, thotë për Radion Evropa e Lirë se niveli i shmangies tatimore është më i lartë te kompanitë e vogla për shkak se edhe kontrollet te to, sipas tij, janë më të rralla. “Këtë e evidentojmë gjatë anketave të realizuara me biznese, por edhe gjatë diskutimeve me bankat komerciale në Kosovë. Shumica e bankave, kur i bëjnë analizat e kredive, marrin parasysh deklarimin e qarkullimit në ATK, por i kërkojnë edhe ata që quhen ‘libra të dyfishtë’ që i mbajnë kompanitë për interesat e brendshme”, thotë Hashani.

Në librat në fjalë ndodh shpesh që bizneset private i regjistrojnë hyrjet e daljet për interesa të veta.

Radio Evropa e Lirë pyeti Bankën Qendrore dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës nëse kërkesat e bankave për evidenca të tilla kanë ndonjë bazë ligjore, por nuk mori përgjigje.



Çfarë është duke u bërë për t'i luftuar shmangiet tatimore?

Në një përgjigje me shkrim të ATK-së, dërguar Radios Evropa e Lirë, thuhet se ky institucion gjatë aktiviteteve për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie vitin e kaluar ka zhvilluar 212 inspektime, ndërsa për 47 persona të dyshuar për shmangie tatimore në ekonomi janë paraqitur kallëzime penale.

Nga këto aktivitete, sipas ATK-së, është vërtetuar se vlera e shmangie nga tatimi ka qenë mbi 9.3 milionë euro. Në vitin 2022 kjo vlerë ka qenë 3.5 milionë euro.

Për shmangie nga tatimi ligji në Kosovë parasheh dënime me gjobë dhe me burgim deri në katër vjet, varësisht nga shumat e përdorur.

Më 9 janar dymbëdhjetë zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës dhe një pronar biznesi u arrestuan nën

dyshimet për shmangie nga tatimi dhe mashtrim në detyrë, por ata u liruan pas 48 orësh në mbajtje.

Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk iu përgjigj kërkesës së Radios Evropa e Lirë për komente në këtë temë.

Nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), i cili monitoron punën e gjykatave, thonë se gjatë procesit të monitorimit të seancave është evidentuar numër i madh i rasteve të veprave penale të shmangies nga tatimi.

Në një përgjigje me shkrim dërguar REL-it thuhet se “në numër shumë më të vogël prokurorët ngrenë edhe aktakuza”. “Nga monitorimi i seancave gjyqësore nga IKD-ja, shumica e rasteve përfundojnë me aktgjykim lirues... Në rastet kur gjykata konstaton fajësinë, dënimet e shqiptuara janë kryesisht me gjobë dhe me kusht”, thotë IKD-ja. Sipas Shatrit, autoritetet e Kosovës duhet të bëjnë inspektime “edhe më rigorozë”.

Me qëllim të parandalimit dhe

luftimit të shmangies tatimore, ATK-ja ka të publikuar në uebfaqen e saj zyrtare një aplikacion për denoncimin apo raportimin e shmangies tatimore.

Për denoncim duhet pasur dëshmi të faturave të parregullta, mallit pa dokumentacion, faturave fiktive, mosmbajtjes apo manipulimit me arkën fiskale, punëtorëve pa kontrata pune e të tjera.

Bashkimi Evropian, ku Kosova mëton të anëtarësohet, e konsideron shmangien tatimore si një “çështje komplekse që paraqet sfida globale”. “Derisa masat kombëtare janë të rëndësishme, ato kurrë nuk mund të kenë sukses vetëm. Kjo është arsyeja pse BE-ja dhe shtetet anëtare të saj duhet të punojnë së bashku, duke përdorur mjete dhe sisteme të përbashkëta dhe duke shkëmbyer praktikatat më të mira. Bashkëpunimi ndërkufitar mbetet vendimtar për arritjen e rezultateve”, vlerëson BE-ja.

Pritej të përfundonte më 2023, autostrada Prishtinë - Gjilan kantier ndërtimi me gropa dhe baltë

Prishtinë, 21 janar - Shumë pak makineri dhe punëtorë u panë duke punuar në atë që njihet si “autostrada Prishtinë - Gjilan” më 17 janar. Ndërtimi nisi para gjashtë vjetësh, por punët në terren duket se po shkojnë shumë ngadalë. Zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës thanë për Radion Evropa e Lirë se janë paraqitur probleme të ndryshme nisur nga rrëshqitja e dheut, riformatimi i kontratave dhe rritja e sipërfaqeve të shpronësimeve. Autostrada Prishtinë - Gjilan ka



filluar të ndërtohet në muajin prill të vitit 2018. Gjatësia e kësaj autostrade është 22.6 kilometra dhe parashihej të përfundonte

brenda 30 muajsh, apo në fund të vitit 2020.

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës thanë se mbeten “optimistë që autostrada deri në Bresalc të finalizohet gjatë këtij viti”.

Në mbledhjen e fundit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2023 është marrë vendim për shpronësimin e disa prej parcelave shtesë në mënyrë që të përfundohet projekti sa më parë. “Problemet që kanë dalë gjatë rrugës kanë ndikuar që projekti të mos finalizohet në vitin 2023,

ashtu siç kemi premtuar. Gjithsesi, ne mbetemi optimistë që autostrada deri në Bresalc të Gjilanit do të finalizohet gjatë këtij viti”, thanë në MMPHI.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në muajin korrik të vitit 2023 kishte inspektuar punët në këtë autostradë. Ai kishte premtuar se “punimet do të përfundojnë brenda vitit 2023, pasi kanë përfunduar 70 për qind e punimeve”.

Kjo autostradë pritet ta lidhë Kosovën me Serbinë Jugore, përkatesisht me Luginën e Preshevës.

A ka njeri që mund ta ndalojë “mbretëreshën” Ursula von der Leyen?

Për një moment vitin e kaluar, dukej sikur oferta e Ursula von der Leyen për një mandat të dytë si presidente e Komisionit European nuk do të ishte e sigurt. Në një udhëtim të paplanifikuar në Izrael në tetor, përkrah Benjamin Netanyahu ajo kishte shprehur solidaritetin pa rezervë në betejën e vendit kundër Hamasit. Deklarata e saj nuk do të konsiderohej e pavend nëse do ta thoshte p.sh presidenti i SHBA-së. Por duke folur si shefe e një prej institucioneve më të fuqishme të Bashkimit European për një nga çështjet më përçarëse në bllok, ajo shkaktoi reagimin më të madh në katër vitet e saj në detyrë. Diplomatat e zemëruar kishin injoruar një deklaratë të përbashkët të ministrave të jashtëm të BE-së që përfaqësonin pozicionin e bllokut dhe bënëin thirrje për përmbajtje dhe respektim të ligjit ndërkombëtar nga Izraeli. Rreth 800 punonjës të Komisionit nënshkruan një letër duke kritikuar mbështetjen e saj “të pakushtëzuar”, “të pakontrolluar” “për njërën nga dy palët” në konflikt. Diplomati më i lartë i Von der Leyen, Josep Borell, e qortoi publikisht për faktin se po fliste për të gjithë BE-në. “Ajo po sillet gjithnjë e më shumë si një mbretëreshë”, tha një diplomat i BE-së për POLITICO-n në atë kohë, duke e kritikuar atë për tejkalimin e përshkrimit të punës së saj, duke i hequr qeveritë e BE-së nga vendimmarrja e saj dhe duke qeverisur me një grup të vogël këshilltarësh. Megjithatë, për disa muaj, pozicioni i von der Leyen është përsëri i fortë. Pa kërkuar falje dhe pa u kthyer prapa, ajo ka përballuar stuhinë politike dhe ka dalë, në mos më e fortë se kurrë, të paktën e padëmtuar. Jo vetëm që ajo mbetet kandidatja kryesore për një mandat të dytë si presidente e Komisionit; Asnjë kandidat tjetër nuk duket se ka shanse për ta zhvendosur atë kur udhëheqësit e BE-së takohen këtë verë për të ndarë pozicionet kryesore të bllokut. Në nëntor, von der Leyen refuzoi të konfirmonte se do të kandidonte përsëri, por me gëzim u përgjigj një pyetjeje se çfarë do të bënte me një mandat të dytë, duke thënë se do të “mbante vëmendjen tek temat e mëdha” domethënë Marrëveshja e Gjelbër, tranzicioni dixhital dhe elasticiteti. Në bisedat me dhjetëra zyrtarë dhe diplomatë të BE-së, pak prej tyre shprehën dyshime serioze nëse do të gëzojë një mandat të dytë nëse ajo e dëshiron. Kritikant në Bruksel janë qetësuar përsëri, ose të paktën janë tërhequr pas dyerve të mbyllura, pasi zyrtarët nuk duan të rrezikojnë të kalojnë në “katin e 13” të selisë së Komisionit në Berlaymont, ku von der Leyen dhe ekipi i saj kanë zyrat e tyre. Teksa ajo iu përgjigj pyetjeve nga POLITICO, ajo shfaqte një vezullim në sy se askush nuk mund ta ndalojë. Por, ndërsa një rikurorëzimi i pakontestueshëm mbetet deri tani rezultati më i mundshëm, ka ende një shans që

gara mund të sjellë surpriza.

Mbretëresha e kthimit në shtëpi

Von der Leyen mbërriti në Bruksel thuajse papritur. Kur emri i saj u shfaq në vitin 2019, ajo ishte mister për pjesën jashtë Berlinit, ku ajo ishte ngjitur në radhët e politikës gjermane nën drejtimin e kancelares së atëhershme Angela Merkel. Për ministrin e atëhershëm gjerman të mbrojtjes, megjithatë, ky emërim ishte një ‘kthim në shtëpi’. Babai i saj Ernst Albrecht ishte një nga nëpunësit e parë civilë të BE-së. 13 vitet e para të jetës i kaloi në lagjen Ixelles të Brukselit, nën hijen e institucioneve të BE-së, duke ndjekur shkollën Europiane. Ishte gjithashtu një shans për të kërcyer nga një anije që po fundosej. Fillimisht e parë si e mbrojtura e Merkelit, karriera e saj ishte zhytur pas një skandali mbi përdorimin e konsulentëve të jashtëm nga ministria e saj pa mbikëqyrjen e duhur. Edhe kur von der Leyen u zhvendos në një nga zyrat më të larta të BE-së, ajo po përballej me një hetim parlamentar Megjithatë, nuk kaloi shumë kohë dhe kritikant po zhdukeshin. Von der Leyen e ktheu shpejt profilin e saj në Bruksel, duke u shfaqur si presidentja më e fuqishme e Komisionit që nga Jacques Delors, titani i politikës Europiane që vdiq në dhjetor. Ajo thuajse fle në selinë e Komisionit. Ajo punon me orë të gjata, duke përfshirë edhe fundjavat. Orari i saj i mundimshëm i punës dhe i udhëtimeve është kthyer në formë shakaje të vazhdueshme në lagjen e BE-së, veçanërisht mes ndihmësve. Performanca e saj nën presion e vulosi atë si një menaxhere të suksesshme të krizës: dinamike, e përgatitur mirë, shumë afër Uashingtonit, e aftë për të kapërcyer mjegullën që ndonjëherë mbështjell Brukselin. Ndërsa aftësia e saj u testua fillimisht nga pandemia COVID-19 dhe më pas nga lufta në Ukrainë, ajo u bë në kryeqytetet anëmbanë Evropës fytyra publike e një makinerie burokratike Europiane ndonjëherë të largët. Udhëheqësit francezë dhe gjermanë shihen si arrogantë dhe të mërzitshëm. Rivali i saj institucional, Presidenti i Këshillit European, Charles Michel, konsiderohet në Bruksel si i shpërqendruar dhe i prirur ndaj gafave, veçanërisht pas skandalit “Sofagate” në të cilin përprjekja e tij e dukshme për të ngritur në skenë von der Leyen gjatë një vizite në Turqi e la atë të dukej seksist, i pavëmendshëm dhe i paafë. Ishte “pothuajse në stilin House of Cards”, tha Theresa Kuhn, profesoreshë e studimeve Europiane në Universitetin e Amsterdemit. “Ajo e përdori atë mundësi për ta shtyrë veten përpara ndërsa ai e pa veten plotësisht në kurth.” Michel njoftoi të shtunën se do të



kandidojë si kandidat në zgjedhjet parlamentare Europiane të qershorit, që do të thotë se ai pothuajse me siguri do të heqë dorë nga pozicioni i tij aktual në korrik.

Cili është problemi?

Problemi për von der Leyen është se forca e saj po rezulton të jetë një nga dobësitë e saj më të mëdha. Në lundrimin e krizave të saj, ajo nganjëherë anashkalon komisionarët apo rrëmben vendimet nga duart e qeverive kombëtare të mësuara të sundojnë ‘trojet’ në Bruksel. Pas pushtimit në mbajtje të fshehta diskutimet rreth sanksioneve, duke u koordinuar me Parisin, Berlinin dhe Romën, por edhe Uashingtonin, dhe duke e paraqitur paketën vetëm në momentin e fundit kur vendet anëtare ishin gati ta konsideronin atë. “BE-ja është kritikuar gjithmonë si e ngadaltë,” tha Kuhn. “Ajo ndonjëherë rrëmben pak fuqi në disa vendime, por nga ana tjetër është mënyra më efektive për t’i bërë gjërat” Kjo mund të jetë e vërtetë. Por qasja e saj monarkike dhe instinktet centralizuese kanë tronditur gjithashtu themelet në Bruksel – dhe jo vetëm në Parlamentin European të rrënuar vazhdimisht, ku ligjvënësit gjithmonë kanë nxitur në mënyrë joefektive për një mbikëqyrje më demokratike. Disa zyrtarë të lartë të Komisionit i thanë POLITICO-s se stili i von der Leyen dhe ekipi i saj po shkakton ankesa në të gjitha nivelet e ekzekutivit të BE-së. “Po na çmend të gjithëve,” tha një zyrtar i Komisionit European, i cili ashtu si të tjerët kërkoi të qëndronte anonim kur diskutohet për shefin e tyre. “Nëse ajo qëndron edhe një mandat, do të ketë një sinjal të qartë nga brenda ndërtesës se gjërat do të duhet të ndryshojnë” Më shqetësuese për von der Leyen është fakti se, acarimi po rritet edhe në kryeqytetet Europiane, pa të cilat ajo nuk mund të sigurojë një mandat të dytë. Diplomatat e BE-së shpesh përpiqen të luajnë me njoftimet e von der Leyen, nga sanksionet në politikën e Kinës, marrëdhëniet me Mbretërinë e Bashkuar dhe së fundmi me qëndrimin e saj ndaj Izraelit. “Ajo e bën punën e saj pa u konsultuar zyrtarisht me shtetet anëtare”, tha një zyrtar i BE-së. Komisioni ka qenë në një përballje të gjatë me kryeministrin hungarez

Viktor Orbán, i cili nuk ka nguruar t’i japë zë kësaj kritike. “Sa shpesh i duket publikut se Evropa po drejtohet nga vetëm një njeri,” tha Orbán së fundmi. “Ajo flet sikur të ishte lider i Evropës – kur në fakt ajo është punonjësjë jonë, punonjësjë jonë me pagesë, detyra e së cilës është të kryejë atë që vendosim ne” Orbán, i cili vetëm ai nuk do të kishte fuqinë për të bllokuar emërimin e saj, mund të jetë i vetmi lider që bën deklaratë publike të kësaj natyre. Por siç ndodh shpesh në Bruksel, është e pamundur të dihet se sa të tjerë fshihen pas tij. Sipas disa zyrtarëve francezë, presidenti francez Emmanuel Macron është i irrituar nga shfaqjet e përsëritura të pavarësisë së von der Leyen. Nismat e saj për luftën Izrael-Hamas u panë në Paris si një “përprjekje personale PR” “para fushatës”, tha një diplomat francez. “Ajo mendon se nuk ka shef mbi kokë,” tha diplomati. “Nëse nuk mund ta kontrollojmë, ajo duhet të vihet nën kontroll. ... Ne i dërguam asaj një mesazh të qartë se jemi ne që i japim asaj mandatin ” Për të marrë detyrën, von der Leyen duhet të emërohet nga liderët Europeanë dhe të konfirmohet nga Parlamenti European. Në vitin 2019, ajo u vendos në detyrë me mbështetjen e partive të vetë-përshkruara pro-Europiane të BE-së: Partia Popullore Europiane konservatore, Socialistët dhe grupi liberal Renéë. Kjo i dha asaj një shumicë të ngushtë: 383 vota, pak mbi minimumin prej 374. Me rritjen e së djathtës ekstreme në të gjithë Evropën, von der Leyen mund të luftojë për të përsëritur atë fitore. “Mund të ketë një surprizë të vërtetë,” tha një anëtar francez i Parlamentit European nga një nga partitë pro-Europiane. Nëse koalicioni dështon këtë herë, “nuk do të ketë shumicë”, tha ligjvënësi. “Dhe tema e von der Leyen thjesht nuk do të ekzistojë më. Nëse nuk gjejmë një shumicë, ajo do të jetë e paqeverisshme” Komentet e ngjashme kanë filluar të vijnë edhe nga diplomatët Europeanë: “Ajo është kryesuesja, pa dyshim, por me këto sondazhe ... është shumë herët të thuhet nëse me siguri do të zgjidhet sërish”, tha një diplomate nga Evropa Qendrore. “Këtë herë gjetja e shumicës mund të jetë vërtet e vështirë dhe shumica mund të jetë vërtet e dobët”, tha një tjetër diplomat. “Si do të ndikojë kjo në rizgjedhjen e saj është e paqartë për mua. Ajo që është e qartë është se në këtë

sfond, është shumë e vështirë të ofrohen garanci të forta”

Sfidat gjyqësore

Një gjykatë pritet të vendosë në fillim të vitit 2024 mbi një padi të ngritur nga New York Times kundër Komisionit European për dështimin për të siguruar akses në mesazhet me tekst të shkëmbyera midis von der Leyen dhe Albert Bourla, CEO i gjigantit farmaceutik Pfizer. Mosmarrëveshja daton në vitin 2021, kur, sipas raportimit të Neë York Times, von der Leyen dhe Albert Bourla negociuan personalisht një marrëveshje vaksine, në të cilën Pfizer ra dakord t’u siguronte vendeve të BE-së 900 milionë doza, ose të mjaftueshme për të vaksinuar bllokun tre herë, me opsionin për të blerë përsëri atë shumë. BE-ja kishte bërë tashmë dy marrëveshje me Pfizer dhe BioNTech, një kompani tjetër vaksinash. Por kjo marrëveshje ishte e paprecedentë në përmasat e saj. Marrëveshjet e mëparshme kishin kaluar përmes një procesi të ndërlikuar negocimi që përfshin një bord me përfaqësues nga të 27 vendet e BE-së, si dhe negociatorë të përzgjedhur. Komisioni u ka mohuar gazetarëve kërkesat për lirinë e informacionit për mesazhet me tekst, me argumentin se nëse ekzistojnë, nuk mund t’i gjejë ato. Një shumëllojshmëri agjencish mbikëqyrëse janë përpjekur gjithashtu të hedhin dritë mbi këtë çështje – pa sukses. Një komision i posaçëm parlamentar që hetonte pandeminë, i cili u përpoq të bënte që presidenti i Komisionit të vinte përpara një paneli për t’iu përgjigjur pyetjeve, nuk mori më shumë qartësi. Skandali nuk ka rezonuar përtej gazetarëve në Bruksel dhe skeptikëve kundër vaksinës. “Ne po flasim për miliarda fitime që fituan këta prodhues të vaksinave,” tha eurodeputetja belge Kathleen Van Brempt, e cila kryesoi komitetin special. Deputetja tha se nuk besonte se Presidentja e Komisionit ishte personalisht e korruptuar, por paqartësia minoi mbikëqyrjen demokratike: “Unë nuk jam kundër fitimit, por gjërat duhet të jenë transparente, të qarta dhe të bëhen sipas rregullave. Dhe ato nuk ishin”. Vetë von der Leyen ka refuzuar ta trajtojë këtë çështje – edhe kur kamerat i janë drejtuar direkt asaj. Deri më tani, kjo ka rezultuar një strategji fituese. ... Nëse von der Leyen është e shqetësuar për të gjitha këto, ajo nuk po e shfaq – dhe as nuk ka gjasa, çfarëdo lajmi që mund të dalë, ta lejojë veten të shihet duke u djersitur. Çfarëdo që të ndodhë, çfarëdo qofshin vendimet, cilatdo qofshin rezultatet e hetimeve të ndryshme, skenari më i mundshëm mbetet i njëjtë: von der Leyen e qetë duke buzëqeshur rrugën e saj drejt një mandati të dytë./Politico.eu

A është Europa gati për kthimin e mundshëm të ish-presidentit Trump në Shtëpinë e Bardhë?



Aleatët e Amerikës në Europë po debatojnë se si të përgatiten nëse ish-presidenti Donald Trump merr një tjetër mandat. Ky diskutim bëhet ndërsa zoti Trump shënoi një fitore të thellë në zgjedhjet paraprake republikane në Ajova, duke çimentuar vendin e tij si kandidati kryesor aktual për të përballur me Presidentin Joe Biden në zgjedhjet e nëntorit. Fitorja e Donald Trump në zgjedhjet paraprake në shtetin e Ajovas, shteti i parë që çeli garën brenda partive, për emërimin e kandidatit presidencial, duket se ishte një kampanë alarmi për aleatët evropianë të Amerikës. I pyetur për mundësinë e rikthimit të zotit Trump në Shtëpinë e Bardhë, presidenti francez Emmanuel Macron

tha se ai do të bashkëpunonte me këdo që zgjidhet në muajin nëntor. “Ata ndajnë të njëjtat vlera si ne. Por është një demokraci që po kalon gjithashtu një krizë, prioriteti kryesor i së cilës është interesi i saj dhe së dyti, çështja kineze. Si evropianë, ne duhet të jemi të qartë për këtë. Kjo është arsyeja pse unë dua një Evropë më të fortë që mund të mbrohet dhe të mos varet nga të tjerët”, tha ai. Presidentët Macron dhe Trump kishin një marrëdhënie të vështirë. Gjatë fushatës në shtetin e Ajovës këtë muaj, ish-presidenti Trump vuri në lojë zotin Macron duke imituar theksin francez të tij, ndërsa kujtonte diskutimet e tyre mbi tarifatat tregtare. Por shqetësimet e Europës

shkojnë përtej personalitetit të kandidatëve në SHBA. Ndërsa agresioni rus në Ukrainë vijon, Kievi ka nevojë urgjente për ndihmën ushtarake perëndimore. Zoti Trump ka thënë se do të kërkonte një marrëveshje të menjëhershme paqeje midis Ukrainës dhe Rusisë. Mbështetësit e tij republikanë në Kongres po bllokojnë rreth 50 miliardë dollarë ndihmë ushtarake për Kievin. Aleatët e NATO-s janë të shqetësuar se ndihmat mund të ndalen plotësisht. “SHBA-ja po paguan rreth gjysmën e shumës të ndihmave perëndimore. Por Uashingtoni ka një rol madhor, në mos më të madhin, kur bëhet fjalë për çështjet strategjike politike në Ukrainë. Pra humbja e SHBA-

së në këtë aleancë, në kuptimin e të paturit të një presidenti që mund të jetë në të vërtetë kundër interesave të Ukrainës dhe interesave të Europës, do të ishte një goditje e madhe”, thotë Fabrice Pothier, ish-drejtor për planifikimin e politikave të NATO-s. Komisioneri i Tregtisë i Bashkimit Evropian, Thierry Breton, tha këtë muaj se zoti Trump kishte deklaruar në vitin 2020 se “SHBA nuk do ta ndihmonte kurrë Evropën nëse sulmohej” dhe do të dilte nga NATO. Njerëz të afërt që punojnë me zotin Trump nuk i komentuan këto deklarata. Ish-presidenti Trump shpesh kërkonte që aleatët e Amerikës në NATO të shpenzonin më shumë për mbrojtjen e tyre. Shumë

evropianë duket se e kanë marrë seriozisht këtë mesazh. “Ne kemi nevojë për një NATO më evropiane. Unë mendoj se amerikanët nuk do të na lënë të vetëm, por është gjithmonë e dobishme të jemi të përgatitur në situatën ku duhet të marrim më shumë përgjegjësi për mbrojtjen tonë. Dhe unë mendoj se amerikanët kanë të drejtë për këtë,” thotë Alexander Stubb, kandidat për president në Finlandë. Europa po investon më shumë në mbrojtje, duke përfshirë rritjen e prodhimit të municioneve dhe armëve për Ukrainën. Por zëvendësimi i rolit qendror që SHBA-ja ka marrë në Ukrainë nën Presidentin Biden do të kërkonte kohë, diçka që Kievi nuk e ka./VOA



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Prishtina i gëzohet Superkupës së Kosovës, fiton kundër Ballkanit

ANTALIA, 21 JANAR - Në një ndeshje mjaft interesante dhe emocionuese në Antalia të Turqisë, Prishtina ka triumfuar kundër Ballkanit, me rezultat 2-1, duke iu gëzuar trofeut të Superkupës së Kosovës. Deri te ky sukses bardhekaltrit e kryeqytetit arritën me golat e shënuar nga Egzon Sinani dhe

Leotrim Kryeziu. Prishtina zhblllokoj shifrat në minutën e nëntë, kur qendërmbrojtësi Sinani shënoi gol të bukur me gjuajtje të saktë nga zona. Ndërkaq, me të filluar pjesa e dytë prishtinasit shtuan epërsinë, pas një aksioni të shkëlqyer, kur sulmuesi Kryeziu shënoi me kokë nga afërsia, pas

harkimit të Kreshnik Ukës. Pas këtij disavantazhi trajneri i Ballkanit, Ilir Daja reagoi me disa zëvendësime, duke përfshirë edhe sulmuesin Krenar Dulaj. E pikërisht ky futbollist shënoi gol në minutën e 79-të, duke ngushtuar rezultatin në 2:1 dhe duke i dhënë shpresa skuadrës së tij për rikthim.

Megjithatë, në minutat e mbetura përkundër disa rasteve portokallezinjtë nga Suhareka nuk arritën të gjejnë edhe golin e barazimit. Me këtë fitore, Prishtina ka siguruar trofeun e 11-të të Superkupës, përkatësisht të nëntin pas çlirimit. Medaljet për të dyja ekipet i ndanë nënkryetarët Bakir



Burri e Agim Dibrani si dhe trajneri legjendar, Ajet Shosholli, derisa trofeun për kapitenin e FC Prishtina, e ndau presidenti Agim Ademi.

Fitorja e 11-të radhazi për Trepçën, Prishtina mposhti Istogun

“Epoka e re”

MITROVICË, 21 JANAR - Trepça ka shënuar fitoren e 11-të radhazi në Prince Caffè Superligë, ndonëse jo pa vështirësi, kësaj radhe ndaj Vëllaznimit me rezultat 88:79 (24:16, 19:31, 20:17, 25:15). Kuqezinjtë e nisën ndeshjen më mirë me një seri prej 4:12, por kundërpërgjigja e vendasve nuk vonoi për të përmbysur shifrat në 18:12, me një seri prej 14:0, ndërsa çereku i parë përfundoi 24:16. Kjo ndeshje ishte e destinuar për rikthime, pasi periudha e dytë ‘foli’ në të mirë të mysafirëve që përmbysën rezultatin dhe shkuan në pushim me rezultat 43:47. Edhe në periodën e

tretë, herë njëra skuadër kalonte në epërsi e herë tjetra, duke bërë që fituesi të vendoset në dhjetë minutat e fundit, e në këtë pjesë, mitrovicasit u mobilizuan dhe në fund ishin më të vëmendshëm për të fituar 88:79. Te vendasit u dalluan Darnell Edge me 22 pikë dhe Dardan Kapiti me 16 pikë e katër kërcime, kurse te mysafirët më i miri ishte Samuel Sessoms me 21 pikë. Trepça vazhdon të jetë lidere me 16 fitore e dy humbje, ndërsa Vëllaznimi në vendin e pestë me tetë fitore e dhjetë humbje. Sigal Prishtina mundi Istogun në kryeqytet me rezultat 68:83 (22:21, 13:21, 18:16, 15:25) në javën e 18-të, ku istogasisit rezistuan për 35



minuta, por bardhekaltrit ishin vendimtarë në pesë minutat e fundit dhe triumfuan me 15 pikë dallim. Në çerekun e parë u zhvillua lojë kryesisht e barabartë, ku

herë njëra skuadër kalonte në epërsi e herë tjetra, por pa mundur për tu shkëputur në rezultat dhe kjo pjesë përfundon 22:21. Por, në periudhën e dytë për një

nuancë prishtinasit ishin më të mirë, duke shkuar në pushim me rezultat 35:42. Lojë kryesisht e barabartë u zhvillua edhe në periodën e tretë, ku shifrat pas 30 minutash ishin 53:58. Megjithatë, në pesë minutat e fundit dhe vendimtar, kryeqytetasit u shkëputën dhe fituan 68:83. Te Istogu u dalluan Arian Azemi me 20 pikë e pesë asistime, Tyres Prince me 17 pikë e 11 kërcime dhe Labinot Kelmendi me 15 pikë, ndërsa më i miri te Sigal Prishtina ishte Fisnik Rugova me 21 pikë, 15 kërcime e pesë asistime. Istogu vazhdon të jetë në vendin e fundit me një fitore e 17 humbje, ndërsa Sigal Prishtina numëron 12 fitore e gjashtë humbje.

Ademi ofron mbështetje në çdo aspekt

ANTALIA, 21 JANAR - Pas ndeshjes së Superkupës, Ballkani-Prishtina, Federata e Futbollit e Kosovës organizoi darkë të përbashkët me të gjitha klubet që po qëndrojnë në fazën përgatitore në Antalia. Gjatë kësaj darke, presidenti Agim Ademi, ua uroi drejtuesve të klubeve fillimin e vitit, duke ju dëshiruar suksese në futboll dhe që t'i arrijnë objektivat e planifikuara, si me klube ashtu edhe me bizneset dhe familjet e tyre. I pari i FFK-së lavdëroi klubet për organizimin e tyre profesional e ekonomik dhe uroi që ato sa më shpejt të



organizojnë edhe infrastrukturën administrative dhe teknike. Ademi tha se ngritja profesionale dhe

rezultatet e Ballkanit dhe klubeve të tjera që ishin në Evropë kanë bërë që liga jonë të jetë më e ranguar në rajon,

e kjo siç tha ai, sjellë edhe më shumë të mira materiale për klube dhe sidomos për futbollistët, ngase liga jonë tashmë është një ndër ligat më të monitoruara nga menaxherët dhe klubet e interesuar për futbollistët tanë. Kreu i FFK-së shprehu shpresën që sa më shumë futbollistë të transferohen në ligat evropiane dhe klubet tona të krijojnë sa më shumë futbollistë të rinj të gatshëm për tregun evropian. Ai u siguroi mbështetje dhe përkrahje klubeve në çdo aspekt, për ato mundësi që

janë në dorën e FFK-së, si dhe u garantoj rregullsi në gara dhe uroi që të kemi një kampionat sa më “fair-play”. “Presidenti Ademi edhe një herë ritheksoi se FFK është në dispozicion të klubeve 24/7 dhe se çdo anëtar përfaqësues i tyre në KE dhe LRF-të do të jenë gjithmonë afër tyre për të adresuar çfarëdo preokupimi apo nevojë. Në fund, Ademi i uroi përfaqësuesit e klubeve për një vit të mbarë e të suksesshëm, teksa fjalimi i tij u përcoll me duartrokitje nga të gjithë pjesëmarrësit”, thuhet në njoftimin e FFK-së.

Kosova kalon tutje pa lojë, Serbia nuk paraqitet

PRISHTINË, 21 JANAR - Kosova U18 e ka fituar ndeshjen në tavolinë ndaj Serbisë U18, pasi kundërshtari nuk u paraqit, në ndeshjen e vlefshme për plasman në pozitën e 5-të në

CEV U18 kualifikimet për EuroVolley. Arsyeja zyrtare e ekipit serb, ka qenë se “9 lojtarë të formacionit të Serbisë kanë qenë me temperaturë, duke u

pamundësuar daljen në teren”. Duke e pas parasysh qasjen refuzuese të Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës, FVK e konsideron të paqëndrueshëm arsyetimin e dhënë nga

Federata Serbe e Volejbollit dhe do të kërkojë nga CEV, që Serbia të sanksionohet për këtë veprim. Kështu, Kosova U18 kalon në fazën e mëtutjeshme të CEV U18 EuroVolley.





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke u bazuar ne nenin 110 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nënpargraf 1.6, nenit 20 dhe 21 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 24 të Ligjit Nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit dhe nenit 12 të Rregullores Nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit si dhe Vendimin KPK/Nr.46, të datës 15 janar 2024, shpall:

KONKURS PUBLIK
PËR REKRUTIMIN E NJËZETETETË (28) KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË SHTETIT NË PROKURORITË THEMELORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PREJ TË CILAVE KATËR (4) POZITË JANË TË REZERVUARA PËR KOMUNITETIN SERB

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJESITË E PROKURORËVE TË SHTETIT

Kompetencat dhe përgjegjësitë e prokurorëve përfshijnë:

- Ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
- Zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
- Sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kodin e etikës profesionale;
- Ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
- Mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, dhe të pandehurve;
- Ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
- Marjten e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
- Ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
- Ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
- Bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;
- Ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj

KRITERET E KËRKUARA LIGJORE

Neni 24 i Ligjit NR. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit parasheh kushtet e përgjithshme:

24.1 Kandidati për emërim për prokuror të shtetit, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë diplomën e fakultetit juridik të vlefshëm në Kosovë;
- Të ketë të kryer provimin e jurispruencës të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë;
- Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;
- Të mos jetë i dënuar për vepër penale, përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën juridike, pas diplomimit;
- Të ketë kaluar provimin për prokuror, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli;
- Të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia.

24.2 Për qëllime të këtij neni përvoja në fushën juridike përfshinë përvojën në çështje juridike në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përvojën si noter dhe përmbarues privat.

DOKUMENTET E NEVOJSHME

Në pajtim me nenin 13 të Rregullores 02/2022 për Rekrutimin, Provimi, Emërimi dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, kandidati duhet të dorëzojë/bashkëngjeshë dokumentet si më poshtë:

- Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
- Certifikata e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- Certifikatën e Provimit të Jurisprudencës të pranuar sipas Ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
- Certifikatën nga evidenca penale lëshuar nga gjykata dhe
- Dëshminë mbi përvojën e punës në fushën juridike;
- Informatat e siguruar nga punëdhënësi për së paku tre (3) vjet të përvojës profesionale në fushën juridike, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në përshkrimin e detyrave të punës, performancën profesionale, masat disiplinore dhe çështjet e tjera që konsiderohen relevante për procesin, të shoqëruara edhe me dokumente mbështetëse për vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale, siç parashihen me këtë rregullore dhe dispozitat e ligjeve të aplikueshme.
- Kandidati mund të dorëzojë edhe publikime profesionale apo akademike dhe informata për pjesëmarrje në trajnime.

MËNYRA E APLIKIMIT

Kandidatët mund të aplikojnë në formë fizike, përmes postës së rregullt, postës elektronike (e-mail) si dhe aplikimit online (aplikacioni elektronik).

Kandidatet mund të aplikojnë në formë fizike ose përmes postës së rregullt, duke shkarkuar dhe plotësuar formularin e aplikimit nga faja zyrtare www.prokuroria-rks.org. Formulari i aplikimit (aplikacioni) së bashku me dokumentet mbështetëse të përcaktuara me konkurs (të vërtetuara), dorëzohen në Zyrën për Verifikim Prokurorial, në adresën Rr.Luan Haradinaj, objekti i Prokurorit të Shtetit, Prishtinë.

Kandidatët të cilët aplikojnë në formë elektronike (email), formularin e aplikimit (aplikacionin) dhe dokumentet e përcaktuara me konkurs, të skanuara mund të i dërgojnë në adresën info.kpk@rks-psh.org.

Ndërsa, kandidatët të cilët aplikojnë përmes aplikacionit elektronik (online) mund të qasen përmes link-ut të veçantë të cilët do të vendosen në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës ose direkt në link-un si në vijim:

[Klikoni këtu për tu ridrejtuar te platforma online](#)

Për informacione për mënyrën e regjistrimit dhe aplikimit online, ju mund të shkarkoni **DORACAKUN** nga platforma online.

NJOFTIM I RËNDËSISHËM PËR KANDIDATËT

Neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, përcakton se procesit të rekrutimit kanë të drejtë t'i nënshtrohen vetëm kandidatët e regjistruar në Këshill, në afatin e paraparë në konkurs për aplikim dhe dokumentacion të kompletuar. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë me konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas kriterëve dhe kërkesave të konkursit, nuk do të merren parasysh.

Afati për dorëzimin e aplikacionit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit, gjegjësisht nga 22.01.2024 deri me 06.02.2024.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

Tužilački Savet Kosova, na osnovu člana 110. stav 2. Ustava Republike Kosova, člana 7. stav 1. podstav 1.6, člana 20. i 21. Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, člana 24. Zakona Br. 08/L-167 za Državnog Tužioca i člana 12. Pravilnika Br. 02/2022 o Regrutovanju, Ispitu, Imenovanju i Ponovnom Imenovanju Državnih Tužilaca kao i Odluke TSK/Br.46, od datuma 15. januara 2024, objavljuje:

JAVNI KONKURS
ZA REGRUTOVANJE DVADESETOSAM (28) KANDIDATA ZA DRŽAVNE TUŽIOCE U OSNOVNIM TUŽILAŠTVIMA REPUBLIKE KOSOVA, OD KOJIH SU ČETIRI (4) MESTA REZERVISANA ZA SRPSKU ZAJEDNICU

OVLAŠĆENJA I ODGOVORNOSTI DRŽAVNIH TUŽIOCA

Ovlašćenja i odgovornosti tužilaca obuhvataju:

- Vršenje tužilačke funkcije na nezavisn, pravičan, objektivan i nepristrasan način i obezbeđuje da se sva lica tretiraju jednako pred zakonom;
- Sprovođenje najviših standarda brige tokom vršenja službenih funkcija;
- Pošteno i profesionalno ponašanje kako u ličnom tako i u profesionalnom životu na osnovu zakona na snazi i kodeksa profesionalne etike;
- Očuvanje časti i dostojanstva Državnog Tužioca;
- Zaštita zakonskih prava žrtava, svedoka i optuženih;
- Preduzimanje potrebnih pravnih radnji za otkrivanje krivičnih dela i izvršilaca krivičnog dela, kao i blagovremeno istragu i procesuiranje krivičnih dela;
- Donošenje odluka o pokretanju, nastavku ili obustavi krivičnog postupka protiv lica osumnjičenih ili optuženih za izvršenje krivičnih dela;
- Podizanje optužnica i njihovo zastupanje pred sudom;
- Korišćenje redovnih i vanrednih pravnih lekova protiv sudskih odluka;
- Saradnja sa policijom, sudovima i drugim institucijama;
- Preduzimanje svih drugih radnji utvrđenih zakonom

ZAKONSKI PROPISANI KRITERIJUMI

Član 24. Zakona BR. 08/L-167 o Državnom Tužiocu predviđa opšte uslove:

24.1 Kandidat za imenovanje za državnog tužioca mora ispunjavati ove uslove:

- Da je državljanin Republike Kosova;
- Da ima diplomu pravnog fakulteta važeću na Kosovu;
- Da je završio pravosudni ispit prihvaćen prema zakonu koji se primenjuje na Kosovu;
- Da ima visoku profesionalnu reputaciju i lični integritet;
- Da nije osuđivan za krivično delo, osim krivičnih dela izvršena iz nehata;
- Da ima najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u pravnoj oblasti , nakon diplomiranja;
- Da ima položen ispit za tužioca, u skladu sa uslovima i postupkom utvrđenim posebnim pravilnikom usvojenim od Saveta;
- Da nema podignutu optužnicu, osim onih podignutih za krivična dela izvršena iz nehata.

24.2 Za potrebe ovog člana, iskustvo u pravnoj oblasti obuhvata iskustvo u pravnim stvarima u domaćim i međunarodnim institucijama i organizacijama, iskustvo kao javni beležnik i privatni izvršitelj.

POTREBNA DOKUMENTA

U skladu sa članom 13. Pravilnika 02/2022 o Regrutovanju, Ispitu, Imenovanju i Ponovnom Imenovanju Državnih Tužilaca, kandidat mora dostaviti/priložiti sledeća dokumenta:

- Popunjenu aplikaciju sa traženim podacima;
- Uverenje o državljanstvu Republike Kosova;
- Diplomu Pravnog Fakulteta važeća u Republici Kosova;
- Uverenje o Pravosudnom Ispitu prihvaćeno prema Zakonu koji se primenjuje u Republici Kosova;
- Uverenje iz krivične evidencije izdato od suda i
- Dokaz o radnom iskustvu u pravnoj oblasti;
- Informacije koje obezbeđuje poslodavac o najmanje tri (3) godine profesionalnog iskustva u pravnoj oblasti, što uključuje, ali nije ograničeno na radnih dužnosti, profesionalni učinak, disciplinske mere i druga pitanja koja se smatraju relevantnim za proces, uz prateća dokumenta za procenu ličnog integriteta i profesionalnih veština, kako je predviđeno ovim pravilnikom i odredbama važećih zakona.
- Kandidat može dostaviti i stručne ili akademske publikacije i informacije o učešću na obukama.

NAČIN KONKURISANJA

Kandidati mogu konkurisati u fizičkom obliku, putem redovne pošte, elektronske pošte (e-mail) kao i online prijave (elektronska prijava). Kandidati mogu konkurisati u fizičkom obliku ili putem redovne pošte, preuzimanjem i popunjavanjem prijavnog obrasca sa službene internet stranice www.prokuroria-rks.org. Obrazac za konkurisanje (aplikacija) zajedno sa pratećom dokumentacijom utvrđenom konkursom (overenom), dostavljaju se Kancelariji ya Tužilačku Verifikaciju, na adresi ul. Luan Haradinaj, objekat Državnog tužioca, Priština. Kandidati koji se prijavljuju elektronskim putem (e-mail), prijavni formular (aplikacija) i dokumentaciju utvrđenu konkursom, mogu poslati na adresu info.kpk@rks-psh.org. Dok, kandidati koji se prijavljuju putem elektronske aplikacije (online) mogu pristupiti putem posebnog linka koji će biti postavljen na zvaničnom sajtu Tužilačkog Saveta Kosova ili direktno preko sledećeg linka:

[Klikni ovde kako bi bio preusmeren na online platformu](#)

Za informacije o tome kako da se registrujete i prijaviti online, možete preuzeti PRIRUČNIK sa online platforme.

VAŽNO OBAVEŠTENJE ZA KANDIDATE

Članom 13. stav 6. Pravilnika Br. 02/2022 o Regrutovanju, Ispitu, Imenovanju i Ponovnom Imenovanju Državnih Tužilaca, propisano je da samo kandidati registrovani u Savetu imaju pravo da budu podvrgnuti procesu regrutacije, u roku utvrđenom konkursom za konkurisanje i kompletiranu dokumentaciju. Dok, kandidati koji nisu konkurisali u roku utvrđenom konkursom, kao i oni koji su se prijavili u roku, a nisu dostavili kompletnu dokumentaciju prema kriterijumima i uslovima konkursa, neće biti uzeti u obzir.

Rok za podnošenje aplikacije je petnaest (15) dana od objavljivanja konkursa, odnosno od 22.01.2024. do 06.02.2024.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Mbikëqyrës i Lartë Bankar (dy pozita)
Grada e pozitës: pesë (5)
Kohëzgjatja e punësimit: pa afat
Pozita: e përhershme
Departamenti: Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare
Divizioni: Divizioni i Mbikëqyrjes në Vend
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrjen në Vend

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Kryen ekzaminimet në vend dhe shqyrton raportet e bankave;
- Udhëheqë ekipin e ekzaminerëve në ekzaminimet në vend në banka;
- Planifikon, koordinon dhe udhëheqë resurset dhe kohën e nevojshme për ekzaminimet në vend në banka;
- Përcakton fushëveprimin e ekzaminimeve në vend dhe identifikon masat detyruese pas ekzaminimit, ndaj bankave;
- Përpilon raportet e ekzaminimit dhe vlerëson përshtatshmërinë e draft raporteve të përgatitura nga ekzaminerët bankarë për fushat e tyre të përgjegjësisë, në ekzaminimet në vend në banka;
- Përgatitë strategjitë mbikëqyrëse konform profilit të rrezikut të bankave dhe i rekomandon mbikëqyrësit shpeshhtësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve në vend;
- Identifikon rreziqet dhe veprimet detyruese si dhe rekomandon përshtatjen e strategjive mbikëqyrëse të bankave;
- Monitoron performancën financiare, zbatimin e rekomandimeve, kërkesat nga ekzaminimet në vend, si dhe zbatimin e masave detyruese të shqiptuara ndaj bankave;
- Sipas kërkesës së drejtorit të departamentit, merr pjesë në ekzaminime dhe kur kërkohet udhëheqë ekzaminimet në vend edhe për IMF – IFJB;
- Udhëzon dhe bartë njohuritë tek mbikëqyrësit bankar dhe mbikëqyrësit e ri bankar;
- Ndihmon në përpilimin e politikave, rregulloreve, udhëzimeve, si dhe procedurave të brendshme tjera të punës;
- Detyra tjera të caktuara nga mbikëqyrësi në kuadër të përgjegjësi të Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Të ketë të kryer fakultetin ekonomik, menaxhment, financa, kontabilitet, matematikë, informatikë;
- Të ketë minimum 3 vite përvojë pune profesionale në risk, financa, kontabilitet, auditim apo të ngjashme.
- Përvoja në banka apo sektorin financiar është e preferueshme.
- Preferohet të ketë diplomë/certifikatë ekuivalent i nivelit të kontabilistit të certifikuar dhe/ose të auditorit të certifikuar.
- Njohuri të shquara analitike, të nevojshme për analiza financiare, si dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e menaxhimit të rreziqeve bankare në banka, IMF dhe IFJB;
- Njohuri të shquara të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), me qëllim të identifikimit dhe verifikimit të përshtatshmërisë së transaksioneve në regjistrimet kontabël të bankave, IMF dhe IFJB;
- Njohuri të shquara për kuadrin ligjor, rregulloret dhe standardet aplikative të zbatueshme ndaj bankave, IMF dhe IFJB-ve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre;
- Kërkohet përpikëri në respektimin e afateve për punët dhe angazhimet e caktuara nga mbikëqyrësi;
- Kërkohen aftësi të shquara për vlerësime dhe vendimmarrje të pavarur nga mbikëqyrësit;
- Kërkohet të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit gojor, komunikimit me shkrim, të dëgjimit dhe prezantimit tek mbikëqyrësi, ekipi i ekzaminimit dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;
- Njohja e mirë e Ms. Office.
- Preferohet të ketë njohje të gjuhës angleze.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **05 shkurt 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta: Viši bankarski nadzornik (dve pozicije)
Stepen pozicije: pet (5)
Trajanje zapošljavanja: na neodređeno
Pozicija: trajna
Odeljenje: Odeljenje za bankarski nadzor
Odsek: Odsek za nadzor na licu mesta
Izveštava: Rukovodiocu Odseka za nadzor na licu mesta

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Vrši kontrolu na licu mesta i pregleda bankovne izveštaje;
- Predvodi tim kontrolora u kontrolama na licu mesta u bankama;
- Planira, koordinira i upravlja resursima i vremenom potrebnim za neposredne kontrole na licu mesta u bankama;
- Definiše obim kontrole na licu mesta i identifikuje obavezujuće mere nakon kontrole, prema bankama;
- Sastavlja izveštaje o kontrolama i ocenjuje adekvatnost nacрта izveštaja koje pripremaju bankarski kontrolori za svoj delokrug rada, u kontrolama na licu mesta u bankama;
- Priprema nadzorne strategije u skladu sa profilom rizika banaka i preporučuje nadzorniku učestalost i obim kontrola na licu mesta;
- Identifikuje rizike i obavezujuće radnje i preporučuje prilagođavanje nadzornih strategija banaka;
- Prati finansijsko poslovanje, sprovođenje preporuka, zahteva iz neposrednih kontrola, kao i sprovođenje obavezujućih mera izrečenih bankama;
- Na zahtev direktora odeljenja učestvuje na kontrolama i, po potrebi, vodi kontrole na licu mesta za MFI – NBFI;
- Daje uputstva i prenosi znanje bankarskim nadzornicima i novim bankarskim nadzornicima;
- Pomaže u sastavljanju politika, propisa, uputstava, kao i drugih internih radnih procedura;
- Drugi poslovi koje poveri nadzornik u okviru nadležnosti Odeljenja za bankarski nadzor.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Da ima završen fakultet ekonomije, menadžmenta, finansija, računovodstva, matematike, informatike;
- Da ima minimalno 3 godine profesionalnog radnog iskustva u oblasti rizika, finansija, računovodstva, revizije ili slično.
- Poželjno je iskustvo u bankarstvu ili finansijskom sektoru.
- Poželjno je imati diplomu/sertifikat koji je ekvivalentan nivou ovlašćenog računovođe i/ili ovlašćenog revizora.
- Izvanredna analitička znanja neophodna za finansijsku analizu, kao i za procenu adekvatnosti upravljanja bankarskim rizikom u bankama, MFI i NBFI;
- Izvanredno poznavanje međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI), u cilju identifikacije i provere prikladnosti transakcija u računovodstvenim evidencijama banaka, MFI i NBFI;
- Izvanredno poznavanje pravnog okvira, propisa i standarda primene koji se primenjuju na banke, MFI i NBFI za procenu njihove usklađenosti;
- Potrebna je tačnost u poštovanju rokova za rad i obaveza koje odredi nadzornik;
- Potrebne su izražene veštine za procenu i odlučivanje koje je samostalno od nadzornika;
- Potrebno je pokazivati odličnu usmenu komunikaciju, pismenu komunikaciju, veštine slušanja i prezentacije nadzorniku, kontrolnom timu i drugim stranama;
- Sposobnost efikasnog rada u timu; veštine upravljanja vremenom u vezi sa izvršenjem i kvalitetom radnih zadataka; sposobnost efikasnog rada sa nadzornikom i timom; sposobnost rada, diskusije i uveravanja sa spoljnim stranama;
- Dobro poznavanje Ms. Office.
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije koju je imao i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Kosovskog fonda penzione štednje (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Procedura prijave:

- Zadnji rok za prijavu je **5. februar 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org



TRADITË QË NGA

1992

